



**Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić**

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 te Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:


**Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI<sup>49</sup>, mbledhja e 5 ) me dt. 31.05.2021  
( e hënë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:**

**R E N D D I T E**

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për faljen e tarifave vjetore të bizneseve private për vitin 2021
4. Dhënia në debat publik e Draft Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike
5. Shqyrtimi i raportit të Komisionit komunal për dhënien e pronave komunale
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

  
**Burim Gërguri**



Dalës-Izazna  
Nr. 1-76  
Br.

Data 20.05.2021  
Datum



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obilić - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt. 30.04.2021, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Enver Gashi (AAK), Florije Jashari (AAK), Qendresa Dubova (AAK), Lulzim Bllaca (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatos Kurshumlija (LDK), Fatmir Bekteshi (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Nora Preniqi, Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjérë: Ibush Mjekiqi, Nënkyrytar i Komunës, drejtoret komunal, Sherif Hoti, menaxher i Prokurimit, Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete, dhe përf. i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal, i cili pasi konstataoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

### R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
3. Shqyrtimi i Projekt Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës
4. Raporti i shpenzimeve për periudhën Janar – Mars 2021
5. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës nr.-II-311, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me atë private të Hashim Rifat Berishës, ZK, Bakshi
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

**Kryesuesi** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

**Lulzim Sadiku** – Propozoj të futet në rend dite një pikë e veçantë, ose ta shtyejmë për një mbledhje të jashtëzakonshme dhe qëllimi është zona me interes të veçantë. Vërtetë, janë duke ndodhë çështje që shumë po shkojnë në favor jo të qytetarëve. Ne e kemi planin zhvillimor të vitit 2010, që aplikohet brenda Komunës dhe kemi edhe planin zhvillimor që kemi biseduar me Kryetarin. Në planin zhvillimor të vitit 2010, te neni 5 shkruan se 200 metra për shirita kanë të drejtë me dhënë leje. Unë në mënyrë miqësore kërkoj ose ta përfshijmë si pikë, ose të mbetet për një mbledhje të jashtëzakonshme, ta formojmë një Komision, ti nxjerim të gjitha dokumentet sepse po i bëhet padrejtësi shumë e madhe Komunës tonë. Pra, kërkoj të mbetet ose për një mbledhje të jashtëzakonshme, ose të jetë si pikë e veçantë, ta formojmë një Komision i cili do të merret me të gjitha vendimet, me vendimin e vitit 2004, 2009, me vendimin e Kuvendit komunal 2019, ose 2020, që vërtetë të iu bëjmë zgjidhje njerëzve sepse ata nuk po mund të përfitojnë as grande, as interes, përkundrazi kanë mbetë në një situatë që nuk kanë si të punojnë dhe jetojnë.

**Kryesuesi** – Mendimi im është që kjo çështje të jetë si pikë e tretë për mbledhjen e radhës, të përgatitemi, ti marrim të gjitha vendimet dhe ti shqyrtojmë. Po ashtu, mund ta ftojmë edhe dikend nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për sqarim të çështjes në fjalë.

**Nazmi Gashi** – Vendimet e Kuvendit komunal, të cilat po i marrim a po zbatohen apo jo sepse nëse, nuk zbatohen, atëherë nuk po i marrim fare vendimet. Fjala, është për vendimin e Komisionit, ku njerëzit kanë

punuar një javë, e tash po thojnë jo ka mjete, jo nuk ka mjete për pagesën e anëtarëve të Komisionit. Vendimet e Kuvendit duhet të zbatohen, është detyrim deshtëm ne apo nuk deshtëm.

**Kryesuesi** – Këtë çështje mund ta diskutojmë në pikën “Të ndryshme”.

Miratohet unanimisht rendi i ditës me propozimin që në mbledhjen e radhës pika e 3 e rendit të ditës të jetë shqyrtimi i çështjes për zonën me interes të veçantë.

**Pika 1 e rendit të ditës**

**Mungoi:** Samire Berisha dhe Armend Rushiti me arsyen.

**Pika 2 e rendit të ditës**

**Lulzim Sadiku** – Unë në mbledhjen e kaluar e kam pyet drejtorin se fshati Hamidi, a është në zonën e interesit. Unë e kam gjetë një vendim dhe këtu shkruan se është në zonën e interesit, por Hamidia nuk është në zonën e interesit, do të thotë është vendimi të cilin e kanë edhe inspektorët. Unë jam konsultuar kështu që fshati Hamidi, nuk është në zonë të interest dhe e kam pyet edhe drejtorin Berisha, i cili atë ditë më ka dhënë përgjegje se është, por nuk është. Është mirë me iu dhënë hapësirë njerëzve dhe leje nëse, iu nevojiten për ndërtim.

Miratohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

**Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Projekt Rregullorja për përkujdesjen dhe mbrojtjes e fëmijës në vitin e kaluar e ka marrë vizën për me dalë në debat publik, por për shkak të pandemisë deri në muajin prill nuk kemi mund me procedurë. Debat publik është mbajtë me dt. 16.04.2021 dhe prezentë kanë qenë një numër i konsiderueshëm i qytetarëve, por vërejtje të theksuar nuk kemi marrë. Kjo Rregullore do të jetë unike në nivelin e Republikës së Kosovës dhe uroj të gjejë zbatim.

**Anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht morën Vendim për aprovin e Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.**

**Pika 4 e rendit të ditës -**

**Kryesuesi** – Për një sqarim më të gjerë rreth raportit të shpenzimeve për periudhën Janar – Mars 2021, fjalën ia dha drejtoreshës së DEFZH-së.

**Zarife Behluli** – Paraqet raportin e shpenzimeve për periudhën Janar – Mars 2021 dhe atë:

Të hyrat vetanake, planifikim janë 950,180.00 €, ndërsa realizim janë 168,871.03 €.

Paga dhe meditje janë 1,101,667.49 €, të shpenzuara, mallra dhe shërbime të alokuara janë 238,874.98 €, ndërsa të shpenzuara 173,902.37 €.

Shpenzimet komunale, alokim janë 72,750.00, ndërsa shpenzim janë 48,736.12.

Subvencionet dhe transferet të alokuara, janë 162,190.81 €, ndërsa shpenzimi është 47,250.00 €.

Te investimet kapitale, të alokuara janë 4,726,958 €, ndërsa shpenzim janë 204,507.16 €, në zotim janë 1,326,602.16 €.

**Lulzim Sadiku** – Unë e kam bërë një analizë dhe të hyrat vetanake të planifikuara janë 950,180 €, të realizuara janë vetëm 168,871 €, më pak se 17 %, dhe unë e kam parasysh këtë fazë që ka më pak të hyra. Megjithatë, mendoj se me këtë trend të dobët të inkasimit të mjeteve Komuna, rrezikon që edhe këtë vit të mos arrijë me i realizue të hyrat e planifikuara. Gjithashtu, edhe niveli i shpenzimeve sidomos te investimet kapitale është tepër i ulët, vetëm 204,507 €, nga buxheti i tërësishëm prej 4,726,958 €, që i bie vetëm 4 % në 3 imjorin e parë shpenzime kapitale. Ky ritëm i shpenzimeve është shqetësues edhe pse e keni parasysh si opozitë se vëllimi i punëve në këtë kohë është akoma i vogël dhe besoj se me këtë trend nuk kemi me i realizue të hyrat e planifikuara dhe prapë rrezikohemi që të jetë suficit. Kërkoj që vërtetë, të hapen shumë projekte sepse gjithmonë po mbetemi me suficit, do të thotë drejtoreshë shpenzimet 4 %, meqë i morëm paga dhe meditje po delë 24. e diçka.

**Aziz Bici** – Te subvencionet dhe transferet për projekte rrugore, buxheti gjithsejt 71,190.82 €, pra këto mjete janë shpenzuar 32,000 €. Pyetja ime është për cilat rrugë bëhet fjalë, qysh mundemi me ditë se cilat rrugë janë ndërtue.

**Ibush Mjekiqi** – Përgjegjet se te subvencionet dhe transferet nuk bëhet investimi në rrugë, por nga mjetet e investimeve kapitale.

**Aziz Bici** – Ndërsa, te shpenzimet kapitale për periudhën Janar – Mars, është fjala për projektin e sinjalizimit horizontal, dhe vertikal, këtu janë 42,000 €, në buxhet ndërsa të zotuara janë 10,000 €. Pyes, ky projekt a ka fillue.

**Naim Miftari** – Pritet me fillue.

**Dragan Dancetovic** – Fatkeqësish, është viti i dytë që aktivitetet tona janë të kufizuara për shkak të koronës, prandaj edhe të gjitha resurset tona teknike e njerëzore janë të shkurtuara. Periudha Janar – Mars, është një kohë kur aktivitetet janë të kufizuara për zhvillime të ndryshme ekonomike, prandaj në kohën në vijim në kohën e verës presim që ta realizojmë një projek për ndërtimin e rrugës dytësore i cili është përgatitë në vitin e kaluar dhe kjo ka të bëjë me rrugën dytësore në fshatin Baimoc. Unë e falenderoj Drejtorinë e infrastrukturës, e cila e ka përgatitë këtë projekt në vlerën prej 95,000 €. Ne bashkë me zyrtarët komunal e kemi vizituar këtë rrugë dhe herën e parë ka qenë shumë pluhur ndërsa, herën e dytë ka qenë me ujë. Qytetarët të cilët i shfrytëzojnë këto rrugica kanë probleme të mëdha dhe shpresojmë se tani janë përbushë kushtet që në këtë vit të realizohet ky projekt.

**Nazmi Gashi** – Drejtoreshë, të gjithë po hyjnë në kredi, ndërsa neve po na teprojnë mjetet. Para 2 viteve, e kam bërë një projekt dhe Kryetari më ka premtue do të thotë projektin është bërë dhe është votuar nga të gjithë kolegët këtu, që i falenderoj, por nuk merret askush më me këtë punë.

**Ibush Mjekiqi** – Pyeti se për cilin projekt konkret është fjala.

**Nazmi Gashi** – Përgjegjet se fjala është për projektin e lagjes Gashi të Sibofcit, ka qenë një fushë e sportit, gjelbërim dhe një objekt për raste të vdekjeve, për të pame për qytetarët. Unë vetë kam punuar në projekt më se 90 % dhe ne kemi qenë shumë transparentë, nuk kemi fshehë asgjë. Mendoj se nuk ka projekt, as vendim që është kërkuar prej neve e që nuk e kemi votue sepse ka qenë në arsyeshmëri të qytetarëve. Drejtori z.Naim, e din se qe 2, ose 3 vjet është mbyllë një kanalizim atje dhe nuk shkon askush me rregullue duke kërkuar çdo ditë se duhet me pastrue një pusetë sepse tash krejtë sistemi po na dëmtohet. Pra, duhet të merren parasysh disa gjëra edhe pse nëpër fshatra banorët janë shumë më të kujdesshëm ndërsa, në qytet nuk po bojshin hiç. Ne duhet ti falenderojmë njerëzit që i kemi me kulturë të veçantë.

**Ibush Mjekiqi** – I përgjegjet z.Nazmi Gashi, se 2 projektet e përmendura janë në realizim, njëra veç ka kalue fusha e sportit do të fillon së ndërtuar shumë shpejtë te shkolla në Sibofc. Ndërsa projektin tjetër për shtëpinë për komunitet është në procedurat e tenderimit dhe do të kryhet shumë shpejtë.

**Zarife Behluli** – Sqaron për mjetet e mbeturë se ju e dini që jemi në situatën e pandemisë dhe sa i përket Prokurimit në fillim të vitit bëhen projekte, pastaj shpallen, do të thotë nuk është e gjatë periudha që nuk janë bërë shpallje aq shumë. Te subvencionet nuk është gabim, por te DSHPE-ja, i kemi me vendim të Kuvendit 300,000 €, për energji elektrike dhe fatkeqësish meqë, jemi në rrëthanat e pandemisë, këto mjetet i shfrytëzojmë vetëm për pandemi. Tani, i përgjegjëm z.Lulzim Sadiku, se 204,507.16 €, janë obligime të mbeturë të vitit të kaluar, ndërsa në këtë vit ende nuk jemi në realizim final të projektit që me u krye pagesa dhe me u rritë përqindja.

**Kryesuesi** – Ne nuk duhet të harrojmë një gjë se rrjedhje të parasë nuk ka deri në shkurt, eventualisht deri në fillim të marsit. Po ashtu, i kemi pasë zgjedhjet e jashtëzakonshme, do të thotë janë disa sfida buxhetore, derisa të formohet Komisioni për transfere dhe alokim të mjeteve, përkundër edhe dëmeve që i kishim nga Covid 19, është për me vlerësue raportin 3 mujor të shpenzimeve për këtë vit.

**Pika 5 e rendit të ditës.**

**Kryesuesi** – Paraqet shqyrtimin e Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës nr.-II-311, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me atë private të Hashim Rifat Berishës, ZK, Bakshi.

**Anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht morën Vendim për aprovin e Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës nr.-II-311, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me atë private të Hashim Rifat Berishës, ZK, Bakshi.**

## Pika 6 e rendit të ditës

**Kryesuesi** – Paraqet kërkesën e DPUKP-së, për pajisje me leje ndërtimore për ndërtim të objekteve për banorët e zhvendosur nga Zona e interesit të veçantë, që atyre të iu mundësohet ndërtimi edhe i podrumeve dhe garazhave në lagjen Hadja e Re.

**Nazmi Gashi** – Ky projekt ka qenë një lloj eksperimenti për Komunën tonë dhe shumë Komuna, kanë mendue se do ta marrin një shembull të zhvillimeve urbane që kanë me ndryshue nga ndërtimet e mëhershme. Unë në cilësinë e kryeinspektorit me të tjerët e kemi mbajtë gjendjen mjaft mirë dhe ne kemi mendue me ndërtue një lagje, pastaj edhe për realizimin e projektit përrymën. Ky ka qenë projekt shumë eksperimental, por nuk kemi arritë që me ua dhënë të drejtën njerëzve, të cilët kanë pasë mjaft telashe. Tash, me rastin e ndërtimit të shtëpive është mirë që mos me mbetë njerëzit pa garazhë dhe podrum sepse po duhen edhe shumë objekte përcjellëse. Unë besoj se DPUKP-ja, mund ta përcjellë situatën dhe të punohet me sukses.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht e aprovuan Vendimin për pajise me leje ndërtimore për ndërtim të objekteve me etazhitë P + K, për banorët e zhvendosur nga Zona e interesit të veçantë sipas kërkesave të tyre që të iu mundësohet ndërtimi edhe i podrumeve dhe garazhave në lagjen Hadja e Re.**

**Kryesuesi** - Tani, ju njoftoj se ka ardhë kërkesa nga Ministria përkatëse për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. -I-344, të dt.30.11.2020, të Kuvendit komunal për vlerën e shujtës ditore nga 2.50 €, në 2.00 €.

**Lulzim Sadiku** – Mendoj se shujta ditore duhet të paguhet që nga janari.

**Kryesuesi** – Sqaron se mjetet paguhen nga muaji janar 2021.

**Aziz Bici** – Ju, na e sjellni nga një kopje të dokumentit të Ministrisë dhe dua të di se në çka është bazuar Ministria.

**Kryesuesi** – Mua, më ka njoftuar Zyra e Personelit dhe ne nuk kemi mund me ua dërgue vendimet e fundit për shkak të vëllimit shumë të madh sepse vetëm një lëndë i ka deri në 500 faqe.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal, unanimisht e aprovuan**

**Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. -I-344, të dt.30.11.2020, të Kuvendit komunal për vlerën e shujtës ditore nga 2.50 €, në 2.00 €, për Shërbyesit Civil të punësuar në administratën e Komunës së Obiliqit.**

**Kryesuesi** – I njoftoi të pranishmit me kërkesat të cilat iu kanë drejtuar për shqyrtim Drejtoreve përkatëse dhe atë:

-Kërkesa nr. -I-8053, e dt.15.04.2021, Zyres së Kryetarit dhe DSHPE-së.

-Kërkesa nr.-I-8527, e dt.22.04.2021, Zyres së Kryetarit dhe DSHPE-së.

**Kryesuesi** – Unë kërkoj falje se në mbledhjen e KPF-së, nuk e kemi shqyrtuar një kërkesë, nga Musli Pajaziti, për shpronësim për një rrugë e cila i rekomandohet DPUKP-së, për shqyrtim.

## Pika 7 e rendit të ditës

**Kryesuesi**–Ne e kemi marrë një vendim para 2 viteve, Komisionet e formuara nga Kuvendi komunal të trajtohen edhe nga ana financiare. Komisioni ka punuar mjaft dhe në media emrat iu kanë dalë se i kanë marrë imjetet, por nö realitet nuk i kanë dhe DEFZH-ja, e ka për obligim që atë vendim me zbatue.

**Nazmi Gashi** – Pyeti se a do të batohen vendimet e Kuvendit komunal.

**Kryesuesi** – Përgjegjet po, patjetër.

**Ibush Mjekiqi** – Secilin Komision të cilin e ka formuar Kuvendi dhe e ka të drejtën e pagesës do të paguhet. Unë mund të them se në këtë 3 mënyrë të këtij viti ka pasë probleme në ekzekutimin e pagesave dhe nuk është problemi krejtë te ne, por është problemi i kodeve, i rregullimit të brendshëm atje, që është normale kjo që ndodhë. Ne i kemi 1,783 persona të cilët duhet ti gjëzojnë nga 100 €, për shkak të Covid

19., sepse kanë rezultuar pozitiv dhe deri më tani kemi mund ti realizojmë vetëm 1,100 pagesa. Pra, ka vonesa rreth pagesës, por të gjitha do të realizohen..

**Labinot Mirena** – Unë bashkë me kolegut z.Bekteshi, kemi qenë te drejtoresha e financave dhe e kemi pyet direkt se cili është problemi që nuk po paguhën Komisionet. Çështja nuk është qe 3 muaj sepse ne punojmë këtu, qe 4 vite dhe Komisionet në të kaluarën janë paguar, e tash nuk janë duke u paguar. Arsyetimi më banal i drejtoreshës së financave, është kur thotë se nuk e di, keni gabuar, është e jashtëligjshme ajo punë që po punoni ju kështu, ju kanë futë në listë të pagave si shoqatë e gjuetarëve. Unë i thashë z. Fatmir se në Kuvend, me llovaqkë në krahë, qenkat gjuetar prej sotit, do të thotë se është shumë banale. Është jo vetëm Komisioni për ndarjen e banesave, por edhe Komisioni për Ansamblin dhe të gjitha Komisionet tjera, që nuk janë paguar. Nëse, ajo nuk din qysh bëhen pagesat atëherë, vjen dikush tjetër që din qysh bëhen pagesat sepse nëse ndodhë që pagesat tonë cilat janë të grumbulluara qe një vit dhe publikisht nëpër media që dolëm se i kemi marrë nga 750 €, u përfolë emri jonë personalisht i imi dhe ne nuk e kemi marrë asnje pagesë deri tash. Unë në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit, vetëm do të vijë dhe do të nënshkruaj, do ta lëshoj mbledhjen në shenjë revolte për shkak të mospagesës së Komisionit. Unë i ftoj të gjithë kolegët me veprue kështu njësoj.

**Ibush Mjekiqi** – Unë sinqerisht shprehu keqardhje, është hera e parë që po e dëgjoj dhe ju asnijëherë nuk keni ardhë me bisedue me mua, as me Kryetarin nuk besoj se keni biseduar. Unë shumë seriozisht do të merrem me këtë punë dhe të gjitha vendimet e Kuvendit komunal, do të realizohen, do të thotë se pagesat do të kryhen..

**Kryesuesi** – Ne edhe në mbledhjen e KPF-së, e kemi trajtuar këtë çështje dhe drejtoreshës së financave i treguan se nuk je autoritet me na tregue se a duhet të zbatohet vendimi i Kuvendit, apo jo. Drejtoresha e financave, duhet ti merrë përsipër ti kryej obligimet e Komisionit, i cili ka bërë një punë të jashtëzakonshme, kanë pasë presion dhe kërcënime, që duhet me i falenderue.

**Fatos Kurshumlija** – Unë e kam një pyetje kryesues, se drejtori i infrastrukturës a është pjesë e Ekzekutivit, apo jo sepse unë nuk e di kur e kam parë atë në mbledhje të Kuvendit. Unë e kam një kërkesë për të dhe për drejtorin e shërbimeve publike, pothuajse qe një vit, do të thotë që nga viti i kaluar te rruga "Shtabi i UÇK"-së, kur është shtruar asfalti, e ka mbylli kanalizimin. Tash, janë 2 familje Simnica, që kanë bërë vetë kërkesë, por po flas edhe unë se përmes telefonit dhe kontakteve të drejtëpërdrejtë me drejtorët e kam bërë kërkesën dhe nuk është duke u realizue. Unë u takova me kryefamiljarin Simnica, ai tha se jam detyrue me hudhë një rimorkio dhe me blloku që me hudhë midis rrugës, se tash vera është duke kundërmuar shumë era.

**Lulzim Sadiku** – Unë e kam një pyetje sepse në Drejtorinë e sportit për monumentet historike dhe arte i kemi ndarë 50,000 €, me buxhet. Ndërsa gjyqtuesi në fshatin Sibofc, vërtetë është duke i prishë këto arte, këto gjëra, me rëndësi historike, që janë në atë pjesë. Ne edhe më heret e kemi pyet Kuvendin komunal, se a i kemi dhënë pëlqim dhe ish drejtori na ka thënë se ne nuk i kemi dhënë kurrfarë pëlqimi, ndërsa ai thotë se kam leje, banorët e ndalin pnën. Unë vërtetë, Nënkyetar kisha dashur me ndërmarrë masa që mos me lënë me dëmtue dhe nëse ne nuk kemi fuqi si Kuvend, e ai ka marrë leje jashtë neve, me i shikue kompetencat që na takojnë, që mos të prishen monumentet historike në atë pjesë. Vërtetë, është shumë shqetësuese dhe mua më intereson se çka ka ndodhë me 50,000 €, nga Drejtoria e sportit, që më kujtohet shumë mirë që i kemi ndarë këto mjete.

**Aziz Bici** – Unë i kam 2 çështje. Siç e dini tash e disa muaj rruga magjistrale |Prishtinë – Vushtrri, në Mazgit afér hyrjes së autostradës është prishur dhe shumë po e vështirëson lëvizjen e automjeteve. Jozytarisht flitet se shkaku i prishjes është rrëmihja që është bërë në afërsi të rrugës. Pyetja ime është se a është konstatuar shkakui i prishjes dhe a ka mundësi që edhe ne si Komunë të jemi fajtor nëse, gabimisht është lëshuar leje për rrëmihje apo për mosndërhyrje me kohë. Pyetja tjetër është se në sheshin "Dëshmorët e kombit" në pushtë përballe bankës Raiffeisen, telekomi ka konstatuar se operatori "SB Construction" i cili po e ndëront këtë shesh, nga pakujdesia e ka këputur kabllon optike të telefonave dhe pse i ka ftuar

inspektorët komunal nuk janë ndërmarrë kurrfarë masash. Kërkoj që inspektorët komunal të ndërtimit ti përgjegjen kërkeseve të operatorëve, qytetarëve në rastin konkret të ftuar qoftë nga personat privat, apo të kompanive të ndryshme. E fundit është rrith një ankesë të një qytetari, fjalë është për Omeroviq Ekrem, i cili nga data 12.10.2018, me familjen e tij banon në objektin e ish shkollës teknike "Nikolla Teslla" në Obiliq. Një kohë të gjatë ka paguar edhe qira për këtë banesë. Tani, ekziston një vendim se kjo familje me dt.08.05.2021, duhet ta liroj banesën duke thënë edhe dhunshëm, mendoj edhe nime polici. Pyetjet e mia janë këto kush është pronar i objekteve dhe trollit të ish shkollës së mesme teknike "Nikolla Teslla" në Obiliq, na tregoni se përvëç që po shfrytëzohen këto objekte, e kam fjalën nga kategoritë e rasteve sociale, apo kush tjetër dhe në të ardhmen çfarë plani keni ju si Ekzekutiv për këto objekte, si do të shfrytëzohen. Kjo familje ka shtëpi në pjesën veriore të Mitrovicës, por deri vonë shtëpia e tyre ka qenë e uzurpuar. Tani, shtëpia e tyre është liruar, por sipas Omeroviq Ekrem, shtëpia e tyre as minimalisht nuk i plotëson kushtet për banim. Ndërsa, kërkesa ime është që familja e z.Omeroviq Ekrem, mos të nxjerret nga kjo banesë derisa nuk i krijohen kushte në tërësi që të kthehet në shtëpinë e tyre.

**Dragan Dancetovic** – Është një kërkësë e grupit të qytetarëve, drejtuar Kryetarit të Komunës dhe drejtorit të kadastrit me dt.27.09.2019, të evidentuar përmes arkivit. Problemi i qytetarëve të këtyre 7 familjeve, nënshkrues të kësaj kërkese është pamundësia e punimit të më shumë se 5 hektarëve, të tokës së punueshme për shkak të uzurpimit të rrugës. Pronari i rrugës së cekur e ka ngritur nivelin e parcelës së vet dhe këtë nuk ia konteston askush, por me ngritjen e nivelit të parcelës dhe niveli i rrugës nuk është në përdorim për këmbësorë dhe për mekanizmin bujqësor. Kjo rrugë është e evidentuar në kadastër, por është shumë e ngushtë dhe është një problem që duhet të zgjidhet. Njëri prej këtyre pronarëve në këtë pjesë jam edhe unë dhe në vitin e kaluar nuk e kam mbjellë fare arën, që ti iku problemeve të panevojshme edhe pse kam pasur humbje në bujqësi, me shpresën se institucionet e Komunës, para së gjithash Drejtoria përkatëse do të merret me këtë çështje me kërkësën e qytetarëve, që të reagoj në njëfarë forme. Ne kemi pasur premtimin nga drejtori i kadastrit z.Arben Berisha, që përmes kompanisë "Ibër Lepenc" ta bëjë zgjidhjen e këtij problemi, por asgjë nuk është bërë në këtë drejtim. Unë më heret kam folë në këtë foltore për këtë problem dhe prapë po e përsëriti të njejtin problem. Ne kërkojmë përmes Komunë që të mbrojmë pasurinë shtetërore dhe atë private dhe poashtu, ta mbrojmë interesin e 50 anëtarëve të këtyre familjeve, që ushqehen nga kjo tokë. Këta, janë njerëz të ndershëm dhe të vyshtëm të cilët dëshirojnë që vetëm ta punojnë tokën e tyre dhe është përgjegjësi e Komunës, që këtë të ua mundësoj.

**Ibush Mjekiqi** – Unë i falenderoj të gjithë për shketësimet e ngritura. Te çështja e rrugës "Shtabi i UÇK"-së, do të merrem me këtë punë të shohim se kur është mbylli ai kanalizim. Z.Lulzim Sadiku që e përmendi çështjen e gurëthyesit po është problem dhe ato 50,000 €, kanë qenë të destinuara për gërmime në fshatin Dardhishtë, por ajo pronë është shitë, do të thotë ka ngelë, nuk e ka dhënë pëlqimin dhe ato mjete janë aty për atë pjesën. Në mbledhjen e radhës të Kuvendit do të keni informata më shumë për çështjet e ngritura. Te sheshi për pushtën z.Aziz, nuk e di sepse është në punim e sipër, por do të kërkoj të dilet në terren nga Drejtoria e inspektoriatit. Te magjistralja, mesi i janarit ka qenë me vërvshime dhe ne i kemi bërë disa veprime të mundshme, por iu kemi tregu se kjo është në menaxhim të Ministrisë. Sipas informative, që i kam ajo është në tenderim dhe këtë e bën Ministria sepse nuk është në kompetencën tonë, por çështja se kush e ka shkaktuar këtë është në konstatim e sipër se cila është arsyaja e prishjes së asaj rruge. Te çështja e banesës z.Aziz, këto banesa nuk janë në menaxhim të Komunës dhe kush e ka lëshuar nuk e di, por jam i sigurtë se institucioni komunal jo. Këtu, ka problem në mes familjesh, familja familjen e ka lëshuar me qira, por Drejtoria e inspektoriatit do të merret me këtë punë në mënyrë që mos të vjen deri te një konflikt i mundshëm.

**Nazmi Gashi** – Në vitin 2004, kanë qenë të shkatërruara të gjitha këto banesa dhe ju e dini se Qeveria e Kosovës, ka ndarë mjete për renovimin e tyre dhe është lëshuar një vendim që përmes Komunës

menaxhohen këto objekte. Tash, ai nuk mundet me jetue në Mitrovicën e veriut dhe me ardhë këtu, në banesën e që e ka renovue Qeveria e Kosovës.

**Ibush Mjekiqi** – Ne nuk mund ta menaxhojmë direkt atë derisa nuk kalon në pronë komunale, ashtu qysh i kemi bërë pronat tjera. Unë me rastin e familjes në fjalë jam marrë bashkë me Drejtorinë e inspektoriatit dhe tash do të merremi. Me çështjen e rrugës në Baimoc, është marrë Drejtoria përkatëse dhe është e vërtetë se ajo rrugë është shumë e ngushtë, por në një drejtim ka mundësi me kalue. DSHPE-ja dhe Drejtoria për infrastrukturë janë në hartim të projektit për shtrimin e asaj rruge, por sido që të jetë e kalueshme mund të bëhet dhe në këtë vit do të bëhet zgjdhja e problemit në atë pjesë.

Ju njoftoj se tani, e kemi çështjen e formimit të një Komisioi komunal, për kompaninë “Pastrimi” të zgjedhen 2 anëtarë nga Kuvendi dhe një anëtar e kemi nga Ekzekutivi. Nga Ekzekutivi, e propozj drejtorin Naim Miftari, në këtë Komision.

**Anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 1 votë kundër e aprovuan Vendimin për formimin e Komisionit komunal të Aksionarëve të Kompanisë “Pastrimi” me këtë përbërje:**

1. Naim Miftari, Kryetar
2. Fatmir Bekteshi, anëtar
3. Lulzim Sadiku, anëtar

**Ibush Mjekiqi** – Ju njoftoj se deri më tani në Komunën tonë gjithsejt janë testuar 4,247 prrrsona, pozitiv kanë rezultuar 1,783, janë shëruar 1,634, ndërsa të vdekur janë 47. Ne kemi pranuar gjithsejt 370 vaksina dhe deri dje janë vaksinuar 338 persona. Ne e presim edhe kontigjentin e dytë në nivel të vendit.

Është kërkuar të kemi një hapësirë më të madhe dhe ne jemi përcaktuar për sallën e sportit “Adem Jashari” kështu që ne jemi të përgatitur edhe në aspektin kuadrovik sa i përket epikit dhe kurdo që vijnë vaksinat ne do të vazhdojmë me vaksinimin e qytetarëve.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:40'**

Bashk.prof.për punë të KK

  
Azize Zeneli

Kryesuesi i Kuvendit komunal

  
Burim Gërguri

